


Qendra e Botimeve për Diasporën, botime dygjuhëshe me “Tregime të moçme shqiptare” nga Mitrush Kuteli



Libri shumë i dashur për shqiptarët “Tregime të moçme shqiptare” nga Mitrush Kuteli, vjen më afër fëmijëve shqiptarë në Diasporë, në sajë të projektit dygjuhësh të Qendrës së Botimeve për Diasporën “Botimi dygjuhësh i dhjetë tregimeve të përzgjedhura nga “Tregime të moçme shqiptare”, me autor Mitrush Kutelin. Qendra e Botimeve për Diasporën e ka përzgjedhur për ta ofruar si literaturë shtesë për shkollat në Diasporë, jo vetëm për vlerat didaktike, por mbi të gjitha për veçanësinë e tij, duke qenë se i njih shqiptarët jashtë vendit (dhe jo vetëm) me trashëgiminë tonë të pasur folklorike. Vepra “Tregime të moçme shqiptare” e Mitrush Kutelit, e vlerësuar me Çmimin Kombëtar të Bibliofilisë nga Biblioteka Kombëtare, është e pasuruar me ilustrimet e veçanta të piktorit të njohur Gazmend Leka. Ky botim pritet të publikohet brenda vitit 2021, në pesë gjuhë, përkatësisht: shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht, shqip-anglisht dhe shqip-frëngjisht.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

Ambasada Shqiptare në Bullgari mbështet dhe promovon platformën “Rrjeti i Profesionistëve”

RRJETI I PROFESIONISTËVE

Ky është një portal që synon të mbledhë e të bashkojë shqiptarët e Diasporës dhe t'ju ofrojë informacione dhe përshkrime të shpejta të shërbimeve të kësaj komuniteti në të njëjtën kohë në vendet ku ata jetojnë dhe t'ju ofrojë informacione dhe shërbime të nevojshme në Diasporë.



BËHU PJESË E RRJETIT

www.rrjetiprofessionisteve.al +355 (0) 44502150 info@rrjetiprofessionisteve.al

Përfaqësitë diplomatike shqiptare mbështesin dhe promovojnë platformën “Rrjeti i Profesionistëve” <http://rrjetiprofessionisteve.al/>, nismë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ambasada u bën thirrje të gjithë profesionistëve shqiptarë në Diasporë të bëhen pjesë e Rrjetit për tu takuar me njëri-tjetrin në një në një hapësirë profesionale dhe bashkëpunuese.

“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”



“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

KKD / Gazmend Kapllani, së shpejti përfundon marrëveshja për botimin në italisht të tri veprave të tij

Shtëpia botuese italiane “Del vecchio editore” lajmëron për bashkëpunimin me shkrimtarin e njohur shqiptar me banim në SHBA, Gazmend Kapllani. Autori i librit të përkthyer në disa gjuhë “Ditar i shkurtër kufijsh” ka njoftuar se së shpejti përfundon marrëveshja për botimin në italisht të tri veprave të tij.



Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora në vendet e Origjinës

Organizata Germin ka publikuar raportin mbi “Angazhimin e Profesionistëve nga Diaspora në vendet e Origjinës”. Në këtë studim kanë marrë pjesë mbi 921 ekspertë nga diaspora me qëllim hulumtimin rreth migrimit qarkor dhe mundësive të angazhimit të profesionistëve të Diasporës në vendet e origjinës.



D Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);